



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 796/1 Prot

Tiranë, më 31.3.2023

VENDIM

Nr. 18, Datë 30.032023

“PËR

MIRATIMIN PARAPRAK TË PROJEKT BUXHETIT TË VITIT 2023 PËR
UNIVERSITETIN E TIRANËS”

Referuar Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma ç, h, neni 49, pika 1, gërma c, ç; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”; VKM-së nr.75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019, të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, pasi mori në shqyrtim Projekt - Buxhetin e hartuar nga Administratori i UT-së mbi propozimet e njëjësive kryesore, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.03.2023:

Vendosi:

1. Miratimin paraprak të Projekt-Buxhetit vjetor të Universitetit të Tiranës për vitin 2023, si më poshtë vijon:
 - Miratimin e detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (Grant mësimdhënie, të ardhura UT), sipas formularit nr.1 të bashkëlidhur;
 - Miratimin e detajimit të shpenzimeve operative, sipas formularit nr.2 të bashkëlidhur;
 - Miratimin e detajimit të investimeve, me objektet sipas formularit nr.3 të bashkëlidhur;
 - Miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve, sipas formularit nr.4 të bashkëlidhur;
 - Miratimin e strukturës së përgjithshme të UT-së, sipas formularit nr.5 të bashkëlidhur.

2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

PROF.DR. ARTAN HOXHA